Po, ju i zûtë shokët që kishin kalue përpara.
Cilët i zûnë shokët që kishin kalue përpara?
Na i zûmë shokët që kishin kalue përpara.
Çka bânë ata?
Ata i zûr shokët që kishin kalue përpara.

A do të zâ unë punë në këtqytet?
Po, ti do të zâsh punë në këtqytet.
Kush do të zâjë punë në këtqytet?
Unë do të zâ punë në këtqytet.
Çka do të bâjë ai?
Ai do të zâjë punë në këtqytet.
A do t'i zâmë na shokët në qoftë se rrijmë mbrapa me mësime?
Po, ju do t'i zêni shokët në qoftë se rrini mbrapa me mësime.
Cilët do t'i zânë shokët?
Na do t'i zâmë shokët.
Çka do të bâjnë ata?
Ata do t'i zânë shokët.

5. A i përshëndes unë oficerat kur i takoj në rrugë?
Po, ti i përshëndet oficerat kur i takon në rrugë.
Kush i përshëndet oficerat kur i takon në rrugë?
Unë i përshëndes oficerat kur i takoj në rrugë.
Çka bân ai?
Ai i përshëndet oficerat kur i takon në rrugë.
A i përshëndesim na njerzit tonë kur shkojmë ndokund?
Po, ju i përshëndetni njerzit tuej kur shkoni ndokund.
Cilët i përshëndesin njerzit e tyne kur shkojnë ndokund?
Na i përshëndesim njerzit tonë kur shkojmë ndokund.
Çka bâjnë ata?
Ata i përshëndesin njerzit e tyne kur shkojnë ndokund.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A e përshëndetshem unë nânën kur dilshem nga shtëpija?
Po, ti e përshëndetshe nânën kur dilshe nga shtëpija.
Kush e përshëndette nânën kur dilte nga shtëpija?
Unë e përshëndetshem nânën kur dilshem nga shtëpija.
Çka bânte ai?
Ai e përshëndettę nânën kur dilte nga shtëpija.
A i përshëndetshim na nënoficerat kur ishim n'ushtrí?
Jo, ju nuk i përshëndetshi nënoficerat kur ishi n'ushtrí.
Cilët nuk i përshëndetshin nënoficerat kur ishin n'ushtrí?
Na nuk i përshëndetshim nënoficerat kur ishim n'ushtrí.
Çka nuk bâjshin ata?
Ata nuk i përshëndetshin nënoficerat kur ishin n'ushtrí.

A e përshëndeta unë gruen kur dola nga shtëpija?
Po, ti e përshëndete gruen kur dole nga shtëpija.
Kush e përshëndeti gruen kur doli nga shtëpija?
Unë e përshëndeta gruen kur dola nga shtëpija.
Çka bâni ai?
Ai e përshëndeti gruen kur doli nga shtëpija.
A e përshëndetëm na komandantin kur erdhi në klasë?
Jo, ju nuk e përshëndetët komandantin kur erdhi në klasë.
Cilët nuk e përshëndetën komandantin kur erdhi në klasë?
Na nuk e përshëndetëm komandantin kur erdhi në klasë.
Çka nuk bânë ata?
Ata nuk e përshëndetën komandantin kur erdhi në klasë.

A përshëndetem unë me shokë kur hŷj në klasë?
Po, ti përshëndete me shokë kur hŷn në klasë.
Kush përshëndetet me shokë kur hŷn në klasë?
Unë përshëndetem me shokë kur hŷj në klasë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Çka bân ai?
Ai përshëndetet me shokë kur hŷn në klasë.
A përshëndetemi na me mësuesit kur i shofim në kafe?
Po, ju përshëndeteni me mësuesit kur i shifni në kafe.
Cilët përshëndeten me mësuesit kur i shofin në kafe?
Na përshëndetemi me mësuesit kur i shofim në kafe.
Çka bâjnë ata?
Ata përshëndeten me mësuesit kur i shofin në kafe.
A përshëndeteshem unë me prindët kur largoheshem nga qyteti?
Po, ti përshëndeteshe me prindët kur largoheshe nga qyteti.
Kush përshëndetesh me prindët kur largohesh nga qyteti?
Unë përshëndeteshem me prindët kur largoheshem nga qyteti.
Çka bânte ai?
Ai përshëndetesh me prindët ur largohesh nga qyteti.
A përshëndeteshim na me mësuesit kur mbarojshim shkollën?
Po, ju përshëndeteshi me mësuesit kur mbarojshi shkollën.
Cilët përshëndeteshin me mësuesit kur mbarojshin shkollën?
Na përshëndeteshim me mësuesit kur mbarojshim shkollën.
Çka bâjshin ata?
Ata përshëndeteshin me mësuesit kur mbarojshin shkollën.

A u-përshëndeta unë me nânën kur u-nisa për Korçë?
Po, ti u-përshëndete me nânën kur u-nise për Korcë.
Kush u-përshëndet me nânën kur u-nis për Korçë?
Unë u-përshëndeta me nânën kur u-nisa për Korçë.
Çka bâni ai?
Ai u-përshëndet me nânën kur u-nis për Korçë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A u-përshëndetëm na me miqt kur i pamë në mensë?
Po, ju u-përshëndetët me miqt kur i patë në mensë.
Cilët u-përshëndetën me miqt kur i panë në mensë?
Na u-përshëndetëm me miqt kur i pamë në mensë.
Çka bânë ata?
Ata u-përshëndetën me miqt kur i panë në mensë.

6. A keni provim javën që vjen?
Jo, javën që vjen s'kemi provim.
A kemi ndonji festë muejin që vjen?
Jo, muejin që vjen s'kemi asnji festë.
Ku do të shkoni vjetin që vjen?
Nuk e dij se ku do të shkoj vjetin që vjen.

A shkuet ndokund javën që kaloi?
Po, javën që kaloi qesh në San Francisco.
A ka rá shí muejin që kaloi?
Jo, muejin që kabi s'ka rá shí.
Ku keni qenë vjetin që kaloi?
Vjetin që kaloi kam qenë n'Europë.

7. A i fshîj unë kambët kur hŷj në nji shtëpí?
Po, ti i fshîn kambët kur hŷn në nji shtëpí.
A i fshîni ju këpucët shpesh?
Po, unë i fshîj këpucët mjaft shpesh.
A i fshîn ai rrobet para se t'i veshi?
Po, ai i fshîn rrobet para se t'i veshi.
A e fshîjmë na dhomën shpesh a rrallë?
Ju e fshîni dhomën rrallë.
A e fshîni ju klasën nji herë në javë?
Po, na e fshîjmë klasën nji herë në javë.
A e fshîjnë ata zyrën çdo ditë?
Po, ata e fshîjnë zyrën çdo ditë.

8. A ke shumë që ke ardhë këtu në Monterey?
Kam tre muej që kam ardhë në Monterey.
A ke shumë që ke fillue me studjue shqip?
Jo, s'kam shumë që kam fillue me studjue shqip.
A ke shumë që ke hangër?
Jo, nji orë mâ parë hangra mëngjes.
A ke shumë që je tue pritë?
Jo, s'kam shumë; nja dhetë minuta.
A ka shumë që âsht nisë?
Jo, s'ka shumë që âsht nisë.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A ka shumë që ka fillue me rá shí?
Jo, s'ka shumë që ka fillue me rá shí.
A ka shumë që ka mrrîjtë treni?
Jo, s'ka shumë që ka mrrîjtë treni.

9. A ju zê gjumi kur hani shumë?
Po, mue më zê gjumi kur há shumë.
A më zê gjumi posa bij me fjetë?
Po, jú ju zê gjumi posa bini me fjetë.
A e zê gjumi atê kur âsht shumë i lodhun?
Po, atê e zê gjumi kur âsht shumë i lodhun.

10. Kur e mbaruet detyrën e shtëpís?
Tash sa e mbarova.
Kur e shkruet letrën?
Tash sa e shkrova.
Kur hangri ai?
Tash sa hangri.

11. A keni qejf me pí ndonji gjâ?
Rakí, po të keni.
A keni qejf me hangër gjellë shqiptare?
Po, kam shumë qejf me hangër gjellë shqiptare.
A ka qejf ai me ardhë me né?
Jo, ai s'ka qejf me ardhë me né.

12. A âsht Zotní Berati mësues?
Po, Zotní Berati âsht mësues.
Po i ati i Zotní Beratit, ç'punë bân?
Edhe i ati ka qenë mësues.
E kujt âsht kjo shtëpí?
Asht e t'et.
Kujt i keni thânë me ardhë?
T'et i kam thânë me ardhë.
A e keni takue ndonjiherë t'anë e Zotní Petrelës?
Jo, s'e kam takue asnji herë t'anë e Zotní Petrelës.
Prejt kujt e keni marrë këtë letër?
E kam marrë prej t'et.

A âsht Zotní Korça peshkatár?
Po, Zotní Korça âsht peshkatár.
Po i biri, ç'punë bân?
I biri âsht berbér.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

I kujt âsht ky dyqan?
Ky dyqan âsht i të birit.
Kujt i a keni dërgue pakon?
Të birit i a kam dërgue pakon.
A e njef të birin e Zotní Korçës?
Po, e kam takue nji herë të birin e Zotní Korçës.
Prej kujt e keni marrë këtë letër?
E kam marrë prej të birit.
A âsht Zoja Leka mësuese?
Po, Zoja Leka âsht mësuese.
Po i shoqi, ç'punë bân?
I shoqi âsht mjek.
I kujt âsht ky automobil?
Ky automobil âsht i të shoqit.
Kujt i a keni dërgue pakon?
Të shoqit i a kam dërgue pakon.
A keni folë me të shoqin.
Po, kam folë me të shoqin.
Prej kujt e keni marrë letrën?
Prej të shoqit e kam marrë letrën.

A âsht Zojusha Përmeti nëpunëse?
Po, Zojusha Përmeti âsht nëpunëse.
Po i fejuemi, ç'punë bân?
I fejuemi punon në nji fabrikë.
I kujt âsht ky qen?
Ky qen âsht i të fejuemit.
Kujt i a keni dërgue rrobet?
Të fejuemit i a kam dërgue rrobet.
A e njifni të fejuemin e Zojushës Përmeti?
Po, e njof të fejuemin e Zojushës Përmeti.
Prej kujt e keni marrë këtë kravatë?
E kam marrë prej të fejuemit të Zojushës Përmeti.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E PESTË
COPË LEXIMI

LESSON 48
PART V
READING TEXT

Feti Kopliku ka ftue për drekë shokun e tij Niazi Kodrën mbasi Lulja, grueja e Niaziut, ka shkue me fëmijët ke prindët n'Elbasan. Niaziu mbasi mrrin ke shtëpija e Fetiut troket në derë dhe Zoja Hyrije i çel (opens) derën. Mbasi përshëndeten, Zoja Hyrije e fton të hŷjë mbrendë. Niaziu fshîn kambët mbasi rrugës kishte baltë dhe kishte ndy (dirtied) këpucët. Atëherë Zoja Hyrije i thotë mos të trazohet e t'urdhënojë e t'ulet në kolltuk. Niaziu ulet. Pyet zojën si po e çon e si âsht me shëndet. Zoja i tregon se gjithë ditën âsht e zâ un me punët e shtepís, por se âsht mirë me shëndet. Zoja Hyrije pyet për Lulen, mbasi familja e Fetiut dhe familja e Niaziut njifen prej shumë vjetësh e kanë miqësí mjaft të madhe; Fetiu e Niaziu janë shokë të vjetër e kanë shkue në shkollë së bashku kur ishin të rij. Atëherë Niaziu i tregon se Lulja do të shkojë edhe në Fier, nga Elbasani, mbasi i vllai me familje dhe i ungji me të nipin banojnë atje.

Zoja Hyrije i kërkon leje Niaziut dhe shkon të thërrasi të shoqin. Mbas pak kohe Fetiu hŷn në dhomën e pritjes dhe përshëndet Niaziun; e pyet në

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

se ka shumë që ka ardhë mbasi nuk e ka ndigjue Niaziun sepse e kishte zânë gjumi tue lexue. Fetiu pyet gruen në se i ka qitë gjâ mikut; atëherë Zoja Hyrije çohet dhe i sjell nji rakí, por pa meze sepse Niaziu tha se mezja i a pret lezetin e bukës.

QUESTIONS - PYETJE

1. Kë ka ftue për drekë Feti Kopliku?
2. Grueja e kujt ka shkue n'Elbasan ke prindët e saj?
3. Kush troket në derë të Feti Koplikut?
4. Çka bân Zoja Hyrije?
5. Cilët përshëndeten?
6. Kush e fton Niaziun të hŷjë në shtëpí?
7. Kush fshin kambët para se të hŷjë në shtëpí?
8. Kujt i thotë Zoja Hyrije mos të trazohet?
9. Ku ulet Niaziu?
10. Kë pyet Niaziu si po e çon?
11. Kush i tregon se gjithë ditën âsht e zânun me punët e shtëpís?
12. Kush e pyet Niaziun për gruen e tij Lulen?
13. Cilat familje njifen prej shumë vjetësh?
14. Cilët janë shokë të vjetër?
15. Ku kanë shkue së bashku Fetiu e Niaziu kur ishin të rij?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School!

16. Kush do të shkojë në Fier ke i vllai?
17. Ku banon i vllai i Lules?
18. Po i ungji me të nipin, ku banojnë?
19. Kush i kërkon leje Niaziut?
20. Kê shkon me thërritë Zoja Hyrije?
21. Kê përshëndet Fetiu kur hŷn në dhomën e pritjes?
22. Kê kishte zânë gjumi tue lexue?
23. Kush e pyet gruen në se i ka qitë gjâ Niaziut?
24. Çka i sjell Niaziut Zoja Hyrije?
25. Kujt i a pret mezja lezetin e bukës?

- Kur e ndien shqiptari veten mâ ngusht se kurrë?
- Kur i vjen nji mik dhe nuk i gjen bukë në shtëpí.

* * *

- Cila âsht mâ e mira meze kur pi njeriu në shoqní?
- Bisedimi i lezetshëm.

* * *

- Çka e bân gjellën mâ të shijshme?
- Urija.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 48
PART VI
HOMEWORK

PJESA E GJASHTË
DETYRË SHTËPIJE

A. Substitute the underlined words with the corresponding contracted form. Example:

Agimi dhe vllai i tij janë nga Tirana.
Agimi dhe i vllai janë nga Tirana.

1. Petriti do të shkojë në kinema me vllán e tij.

2. Lulja ka marrë letër prej nipit të saj.

3. Unë njof Zojën Kopliku, por jo burrin e saj.

4. Ky âsht automobili i Kapter Qafzezit; ai atje âsht i djalit të tij.

B. Answer the following:

5. Qysh i përshëndetni shokët kur vîni në klasë në mëngjes?

6. Në çë rasë i përshëndetni shokët me fjalët "natën e mirë"?

7. Zakonisht, mbas sa minutash ju zê gjumi kur bini me fjetë?

8. Kur nji njeri ju përshëndet "mirë se ju gjeta," qysh përgjigjni ju?

C. Translate the following:

9. He just stepped out.

10. Last night I went to bed at 9 o'clock, but I fell asleep at 12.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 48
PART VII
VOCABULARY

PJESA E SHTATË
FJALORI

i ati	(m.)	his or her father
baltë, -a	(f.)	mud
i biri, të bijt	(m.)	his or her son(s)
me fshî (unë fshîj)	(v.)	to sweep, wipe, erase
gjumë, -i	(m.)	sleep
lezet, -i	(m.)	pleasure; taste, savor, relish
i nipi, të nipat	(m.)	his or her nephew(s)
me përshëndetë (unë përshëndes)	(v.)	to greet, salute, bid good-bye
me u-përshëndetë (unë përshëndetem me...)	(v.)	to greet each other, bid good-bye
i shoqi	(m.)	her husband
me trokitë (unë trokas) (troket dera)	(v.)	to knock (at the door, etc.) somebody is knocking at the door
me thirrë, thërritë (unë thërras)	(v.)	to call; shout; invite; to send for someone
i ungji	(m.)	his or her uncle (from father's side)
i vllai të vllaznit	(m.)	his or her brother(s)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Notes:

me fshi kambët	to wipe off shoes on the door-mat
mos u-trazoni!	Don't bother!
mirë se erdhët!	Welcome! (as a greeting to a guest)
mirë se ju gjeta!	reply to mirë se erdhët
Si po e çoni?	How is everything? How's it going?
punë shtëpije	chores, housekeeping
javën që vjen	next week
A ke shumë që ke ardhë?	Has it been long since you came here?
me zânë gjumi (më, të, i etj. zê gjumi)	to fall asleep
tash sa erdha	I just came.
me prê lezetin e bukës	to spoil the appetite
me pasë qejf (unë kam qejf)	to like, wish
si të keni qejf	as you please, as you wish
për të mirë!	Cheers!
të bâftë mirë!	reply to për të mirë ; Good appetite!

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 49
PART I

PJESA E PARË
USHTRIME GRAMATIKORE PARAPRAKE-GRAMMAR PERCEPTION DRILL

Kur due të marr nji cingare nga nji paqetë mbi tryezë thom:
Me leje nji cingare?
Po, urdhënoni!

Kur due të lexoj nji gazetë që ka blé nji shok i thom:
Me leje t'a lexoj këtë gazetë?
Po, urdhënoni! (lexonie)

Kur due me hapë dritoren thom:
Me leje t'a hap dritoren?
Po, urdhënoni! (hapnie)

Kur due me pá nji libër që ndodhet mbi tryezë thom:
Me leje t'a shof këtë libër?
Po, urdhënoni! (shifnie)

Kur due me kalue nëpër nji derë ku gjindet dikush i thom:
Me leje të kaloj?
Urdhënoni!

Kur due me u-ulë në nji karrigë që âsht e dikujt i thom:
Me leje t'ulem në këtë karrigë?
Urdhënoni!

Kur due të ndal nji njerí për t'a pyetë se ku âsht rruga kryesore i thom:
Me leje! Ku âsht rruga kryesore?
Si quhet kjo rrugë?
Ku ka nji restaurant?
Kush âsht i zoti i këtij dyqani?

Automobili i tij âsht i rí.
A âsht automobili i tij i rí?
Po, automobili i tij âsht i rí.
A e ka ai automobilin të rí?
Po, ai e ka automobilin të rí.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Petkat tona janë të reja.
A janë petka tona të reja?
Po, petkat tona janë të reja.
A i kemi na petkat të reja?
Po, na i kemi petkat të reja.

A janë djelmt e tyne të mirë?
A janë djelmt e tyne të mirë?
Po, djelmt e tyne janë të mirë.
A i kanë ata djelmt të mirë?
Po, ata i kanë djelmt të mirë.

For further practice, drill the above examples using the verbs: me u-takue and me u-pá.

Ju doni me shkue sot në kinema.
Dje: Ju deshët me shkue dje në kinema.

Dje: A desha unë me shkue dje në kinema?
Po, ju deshët me shkue dje në kinema.

A deshët ju me shkue dje në kinema?
Po, unë desha me shkue dje në kinema.

A deshi ai me shkue dje në kinema?
Po, ai deshi me shkue dje në kinema.

A deshëm na me shkue dje në kinema?
Po, na deshëm me shkue dje në kinema.

A deshën ata me shkue dje në kinema?
Po, ata deshën me shkue dje në kinema.

For further practice ask questions on the following statements:

Javën që kaloi desha me folë me jú.
Vjet desha me blé shtëpí.
Dola jashtë sepse desha me pí nji cingare.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Djali im âsht oficer.
A âsht djali im oficer?
Po, djali juej âsht oficer.
A e kam unë djalin oficer?
Po, ju e keni djalin oficer.
Klasa juej âsht e madhe.
A âsht klasa juej e madhe?
Po, klasa ime âsht e madhe.
A e keni ju klasën të madhe?
Po, unë e kam klasën të madhe.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E DYTË
DIALOGU

LESSON 49
PART II
DIALOGUE

Instituti i Ministrís së Mbrojtjes për Gjuhë të Hueja

1. Me leje, Zotní! Dishroj të njifem me jú. Unë jam Feti Rustemi.
2. Gëzohem shumë. Po a shqiptár qenkeni ju?

3. Po, prandej desha të ju takoj. Si e keni emnin?
4. Fatbardh Leka. Kush ju tha se jemi bashkatdhetarë?

5. Nji mik i përbashkët që ndodhet këtu në gostí. Prej nga jeni?
6. Nga kryeqyteti i Skënderbeut, nga Kruja. Po ju?

7. Unë kam lé këtu, por prindët i kam nga Devolli.
8. Oh, sa mirë folkeni shqip!

9. Çë punë bâni, Zotní Leka?
10. Jam arsimtár; mësoj shqip.

11. Në çë shkollë?
12. N'Institutin e Ministrís së Mbrojtjes për Gjuhë të Hueja.

13. Ku gjindet ky institut?
14. Në Presidio të Monterejt, Monterej, Kaliforní.

15. Pse quhet ky institut "i Ministrís së Mbrojtjes"?
16. Sepse nxânsit vîjnë nga Fuqít e Armatosuna: nga Ushtrija, Aviacioni, Marina dhe Kambësorija e Marinës.

17. A s'ka nxânës civila n'at institut?
18. Po, ka nganjiherë, por jo shpesh. Po ju, ç'punë bâni?

19. Kam nji gjelltore; jam edhe pronár tokash.
20. Më falni nji minut! Due të përshëndes zojën e shtëpís.

21. As unë s'e kam përshëndetë ende; po vîj me jú.
22. Mirë, ejani!

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 49



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

PJESA E DYTË
DIALOGU

LESSON 49
PART II
DIALOGUE

Defense Language Institute

1. Pardon me, sir! I'd like to introduce myself. I'm Feti Rustemi.
2. Very glad to know you. I see you are Albanian!

3. That's why I wanted to meet you. What's your name?
4. Fatbardh Leka. Who told you that we are fellow countrymen?

5. A friend of ours (both of us) who is here at the party. Where are you from?
6. From the capital city of Skënderbeg, from Kruja; what about you?

7. I was born here, but my parents are from Devoll.
8. You speak Albanian very well!

9. What kind of work do you do Mr. Leka?
10. I'm a teacher; I teach Albanian.

11. At what school?
12. At the Defense Language Institute.

13. Where is this Institute located?
14. At the Presidio of Monterey, Monterey, California.

15. Why is this Institute called Defense Language Institute and not Army Language Institute?
16. Because the students are from all services (Armed Forces): from the Army, Air Force, Navy and the Marines.

17. Are there civilian students in the Institute?
18. Yes, there are sometimes, but not often. What about you; what do you do?

19. I have a restaurant and I own some land.
20. Excuse me a second, I want to greet the hostess.

21. I haven't greeted her either; I'll go with you.
22. All right, let's go.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School:

LESSON 49
PART III

PJESA E TRETË
ANALIZË GRAMATIKORE

GRAMMAR ANALYSIS

NOUNS: Adjectives used as nouns (part II)

Declension--feminine:

SINGULAR

	Indefinite		Definite	
Nom.		nji e mirë		e mira
Gen.	i, e, të	nji së mire	i, e, të	së mirës
Dat.		nji së mire		së mirës
Acc.		nji të mirë		të mirën
Abl.	prej	nji së mire	prej	së mirës

PLURAL

	Indefinite		Definite	
Nom.		disa të mira		të mirat
Gen.	i, e, të	disa të mirave	i, e, të	të miravet
Dat.		disa të mirave		të miravet
Acc.		disa të mira		të mirat
Abl.	prej	disa të mirave	prej	të miravet

Omission of the possessive adjective:

Prindët e mij janë nga Devolli.
(My parents are from Devoll.)

Automobili im âsht i rí.
(My car is new.)

Djali i tij âsht mjek.
(His son is a physician.)

Shkolla e tyne âsht larg prej këtu.
(Their school is far away from here.)

Librat tonë janë të kushtueshëm.
(Our books are expensive.)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Motrat e tua janë të martueme.
(Your sisters are married.)

Nâna e saj âsht e sëmundë.
(Her mother is sick.)

Djali im ka qenë 20 vjeç kur vdiq.
(My son was 20 years old when he died.)

Djelmt e mij do të jenë të rritun 5 vjetësh.
(My sons will be grown-ups in [after 5] years)

Sentences like the ones above, constructed with a subject made up of a noun and a possessive adjective followed by the verb me qenë are very frequently built differently. The same idea is expressed by having the owner as the subject of the sentence and the object owned as the direct complement connected with the verb me pasë. Thus, the above sentences would become:

Unë i kam prindët nga Devolli.
Unë e kam automobilin të ri.
Ata e kanë shkollën larg prej këtu.
Na i kemi librat të kushtueshëm.
Ti i ke motrat të martueme.
Ajo e ka nânën të sëmundë.
Unë e kam pasë djalin 20 vjeç kur vdiq.
Unë do t'i kem djelmt të rritun mbas 5 vjetësh.

Use of me leje and më falni.

In general, every time one asks permission to do or to have something, as for example when a person is ready to leave, when he is trying to pass through a crowd, when he wants to address someone, etc., he must say me leje. But if he has to interrupt a conversation or apologize he must say më falni. Examples:

Me leje, Zotni (Zojë, etj.). Tash duhet të çohem se ndejta shumë.
(Will you excuse me sir (madame, etc.). I have to leave because I stayed too long.)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Me leje! Ku âsht Zyra e Postës?
(Sir! Where is the post office?)

Më falni! Si thatë se quhet ai njerí?
(I beg your pardon! What did you say his name was?)

Më falni se erdha pak vonë.
(Forgive me for coming a little late.)

Anyway, the verb <u>më falni</u> means "I apologize," "I am sorry," "pardon me," "forgive me," and it's never a question. The prepositional phrase <u>me leje</u> could be a question or a statement, and it means "may I," "excuse me," or "allow me." It's used when one asks permission to do something. It's never an apology.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 49
PART IV
GRAMMAR DRILL

PJESA E KATËRT
USHTRIME GRAMATIKORE

A kam unë dý shtëpí?
Po, ju keni dý shtëpí.

A âsht njâna e ré dhe tjetra e vjetër?
Po, njâna âsht e ré dhe tjetra e vjetër.

A ka e reja katër dhoma fjetje?
Po, e reja ka katër dhoma fjetje.

A ka e vjetra dý dhoma fjetje?
Po, e vjetra ka dý dhoma fjetje.

Cila shtëpí ka katër dhoma fjetje?
E reja ka katër dhoma fjetje.

Cila shtëpí ka dý dhoma fjetje?
E vjetra ka dý dhoma fjetje.

A banoj unë në të rén?
Po, ju banoni në të rén.

A e ap me qirá të vjetrën?
Po, ju e epni me qirá të vjetrën.

Në cilën shtëpí banoj unë?
Ju banoni në të rén.

Cilën shtëpí ap me qirá?
Ju epni me qirá të vjetrën.

A marr njimijë lekë qirá prej së vjetrës?
Po, ju merrni njimijë lekë qirá prej së vjetrës.

A âsht kuzhina e së rés e madhe?
Po, kuzhina e së rés âsht e madhe.

A âsht kuzhina e së vjetrës e vogël?
Po, kuzhina e së vjetrës âsht e vogël.

Kuzhina e cilës shtëpí âsht e madhe?
Kuzhina e së rés âsht e madhe.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Kuzhina e cilës shtëpí âsht e vogël?
Kuzhina e së vjetrës âsht e vogël.

A keni ju motra?
Po, unë kam dý motra: nji të madhe dhe nji të vogël.

A i shkrueni shpesh së madhes?
Po, së madhes i shkruej shpesh.

Po së voglës, a i shkrueni?
Po, edhe së voglës i shkruej.

Cilës motër i shkrueni mâ shpesh?
Së madhes i shkruej mâ shpesh.

Cilës motër i shkrueni mâ rrallë?
Së voglës i shkruej mâ rrallë.

Sa letra merrni prej së madhes?
Unë marr dý letra në muej prej së madhes.

Sa letra merrni prej së voglës?
Unë marr nji letër në muej prej së voglës.

Statements:

Ai e mban pêndën e kuqe në xhep;
pêndën e verdhë e mban mbi tryezë.

Cilën pêndë mban ai në xhep?
Ai e mban në xhep të kuqen.

Cilën pêndë mban ai mbi tryezë?
Ai e mban të verdhën mbi tryezë.

Cila âsht pênda që mban ai në xhep?
E verdha âsht pênda që mban ai në xhep.

Cila âsht pênda që mban ai mbi tryezë?
E kuqja âsht pênda që mban ai mbi tryezë.

Me cilën pendë shkruen ai mâ shpesh?
Ai shkruen me të verdhën mâ shpesh.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Sa kushton e verdha?
E verdha kushton 20 lekë.

Po e kuqja sa kushton?
E kuqja kushton 25 lekë.

Statements:

Zotní Berati i a dha shtëpín vajzës së madhe;
vajzës së vogël i dha 20.000 lekë.

Cilës vajzë i a dha shtëpín Z. Berati?
Z. Berati i a dha shtëpín së madhes.

Cilës vajzë i dha 20.000 lekë?
Së voglës i dha 20.000 lekë.

E cilës vajzë âsht tash shtëpija?
Tash shtëpija âsht e së madhes.

Të cilës vajzë janë tash 20.000 lekët?
Tash 20.000 lekët janë të së voglës.

Me u-njoftë me ....

A njifem unë me Zotní Korçën?
Po, ju njifeni me Zotní Korçën.

A njife ti me Zojën Korça?
Po, unë njifem me Zojën Korça.

A njifet ai me Zojushën Korça?
Po, ai njifet me Zojushën Korça.

A njifemi na me Zotní Beratin?
Po, na njifemi me Zotní Beratin.

A njifeni ju me Zojën Berati?
Po, na njifemi me Zojën Berati.

A njifen ata me Zojushën Berati?
Po, ata njifen me Zojushën Berati.

A njifeni ju me ndonji oficer?
Po, unë njifem me shumë oficera.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School

A njifeni ju me ndonji mjek?
Po, unë njifem me dy mjekë.

A njifet ai me mjekun e ushtrís?
Po, ai njifet me mjekun e ushtrís.

A njifemi na me ndonji mësues?
Po, na njifemi me nji mësues.

A njifemi na me mësuesin e shqipes?
Po, na njifemi me mësuesin e shqipes.

A njifeni ju me shumë oficera?
Po, unë njifem me shumë oficera.

A njifeni ju me oficerat shqiptarë?
Po, unë njifem me oficerat shqiptarë.

A njifet ai me ndonji vajzë?
Po, ai njifet me nji vajzë.

A njifen ata me vajzën e bukur?
Po, ata njifen me vajzën e bukur.

A njifemi na me shumë vajza?
Po, na njifemi me shumë vajza.

A njifeni ju me vajzat shqiptare?
Po, na njifemi me vajzat shqiptare.

Aorist: me u-njoftë

A u-njofta unë me Z. Sadikun?
Po, ju u-njoftët me Z. Sadikun.
A u-njofte ti me Zojën Sadiku?
Po, unë u-njofta me Zojën Sadiku.
A u-njoft ai me Zojushën Sadiku?
Po, ai u-njoft me Zojushën Sadiku.

A. u-njoftëm na me nji vajzë?
Po, na u-njoftëm me nji vajzë.
A u-njoftët ju me nji zojë?
Po, na u-njoftëm me nji zojë.
A u-njoftën ata me dy oficera?
Po, ata u-njoftën me dy oficera.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A u-njoftën ata edhe me mikun tuej?
Po, ata u-njoftën edhe me mikun tim.

me dashë

A desha unë të shkoj në shtëpí?
Po, ju deshët të shkoni në shtëpí.
A deshe ti të flejsh heret?
Po, unë desha të flej heret.
A deshi ai të shkojë në kinema?
Po, ai deshi të shkojë në kinema.
A deshëm na të shkojmë në teatër?
Po, na deshëm të shkojmë në teatër.
A deshët ju të rrini në shtëpí?
Po, na deshëm të rrijmë në shtëpí.
A deshën ata të zgjohen vonë?
Po, ata deshën të zgjohen vonë.

Kush deshi kafe?
Unë desha kafe.
A deshi edhe ai kafe?
Po, edhe ai deshi kafe.
Po ju, a deshët kafe?
Po, edhe na deshëm kafe.

Kush deshi âmbëlsinë?
Ata deshën âmbëlsinë.
Kush deshi âmbëlsinë dhe kafe?
Na deshëm âmbëlsinë dhe kafe.

me ardhë me

A doni me ardhë me mue?
Po, unë due me ardhë me jú.
A vijshe ti me mue kur ishe në katund?
Po, unë vîjshem me jú kur ishem në katund.
A do të vîjë ai me jú nesër?
Po, ai do të vîje me mue nesër.

A keni ardhë me né shpesh herë?
Po, unë kam ardhë me jú shpesh herë.
A erdhën ata me né dje?
Po, ata erdhën me né dje.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School

me pasë diçka: e kam - âsht

A e kam unë babën në Shqipní?
Po, ju e keni babën në Shqipní.
A âsht baba im në Shqipní?
Po, baba juej âsht në Shqipní.
A e ke ti kushrînin mësues?
Po, unë e kam kushrînin mësues.
A âsht kushrîni yt mësues?
Po, kushrîni im âsht mësues.
A e ka ai djalin oficer?
Po, ai e ka djalin oficer.
A âsht djali i tij oficer?
Po, djali i tij âsht oficer.

A e kemi na mësuesin shqiptár?
Po, na e kemi mësuesin shqiptár.
A âsht mësuesi ynë shqiptár?
Po, mësuesi ynë âsht shqiptár.

A i keni ju librat në shtëpí?
Po, na i kemi librat në shtëpí.
A janë librat tuej në shtëpí?
Po, librat tonë janë në shtëpí.

A i kanë ata miqt të pasun?
Po, ata i kanë miqt të pasun.
A janë miqt e tyne të pasun?
Po, miqt e tynë janë të pasun. (të vorfën, të mirë, të këqij, të zellshëm, etj.)

Kê ka ai në Shqipní? (babën, vllán, motrën)
Kê ka ai oficer? (kushrînin, nipin)
Kê kam unë kushrî? (Agimin, Skënderin, Bardhylin)

me leje

A thoni ju "me leje" kur dishroni me folë me nji njerí?
Po, unë thom "me leje" kur dishroj me folë me nji njerí.
A thoni "me leje" kur doni me marrë ndonji send?
Po, unë thom "me leje" kur due me marrë ndonji send.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Çka i thoni nji vajze kur dishroni me këcye?
Kur dishroj me këcye, unë i thom nji vajze "me leje."
Çka i thoni mësuesit kur keni ndonji nevojë?
Kur kam ndonji nevojë, unë i thom mësuesit "me leje."

Thoni Z. .... se dishroni me folë.
Me leje, Z. .... dishroj me folë me jú.
Thoni Z. .... se dishroni nji gotë ujë.
Me leje, Z. .... dishroj nji gotë ujë.
Thoni zojushës se dishroni nji kafe.
Me leje, Zojushë, dishroj nji kafe.

<u>më falni</u>

A thoni ju "më falni" kur bâni ndonji gabim?
Po, unë thom "më falni" kur bâj ndonji gabim.
Çka thoni ju kur doni me u-largue?
Unë thom "më falni" kur due me u-largue.
A mund të thoni edhe "me leje të shkoj" kur doni me u-largue?
Po, na mund të thomi edhe "me leje të shkoj" kur duem me u-largue.

Thoni Z. .... me ju falë se u-vonuet.
Më falni Z. .... se u-vonova.
Thoni Z. .... me ju falë se harruet me i dhânë nji cingare.
Më falni Z. .... se harrova me ju dhânë nji cingare.
Thoni Z. .... me ju falë se nuk e kuptuet.
Më falni Z. .... se nuk ju kuptova.
Thoni Z. .... me ju falë se thyet xhamin.
(dritoren, gotën, shishen, etj.)

Statements:

<u>Ky mësim âsht shumë i lehtë</u>.
<u>Sa i lehtë âsht ky mësim</u>!

Thoni Z. Kadriut se ky mësim âsht shumë i lehtë.
Sa i lehtë âsht ky mësim, Z. Kadri!
Thoni Z. Palit se ka ardhë shumë heret.
Sa heret keni ardhë, Z. Pali!

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Thoni Z. Todit se lexueka shumë shpejt.
Sa shpejt lexuekeni, Z. Todi!
Thoni Z. Hasanit se folka shumë ngadalë.
Sa ngadalë folkeni, Z. Hasani!
Thoni Z. Drinit se shkrueka shumë bukur.
Sa bukur shkruekeni, Z. Drini!
Thoni Z. Latifit se e paska shkrue letrën shumë keq.
Sa keq e paskeni shkrue letrën, Z. Latifi!
Thoni Z. Hysenit se ka fjetë shumë.
Sa shumë paskeni fjetë, Z. Hyseni!

Si ju quejnë?
Mue më quejnë Sadik Meta.
Si e ke emnin?
Unë e kam emnin Sadik Meta.
Si e keni emnin?
Unë e kam emnin Dalip Sula.
Si e ka emnin ai?
Ai e ka emnin Petro Vuçani.
Si e ka emnin baba juej?
Baba im e ka emnin Rexhep Shala.

Si e ka emnin shoku (miku, oficeri, nënoficeri, berberi, mjeku, mësuesi) juej?

Statements:	Questions:
Unë jam mjek.	Ç'punë bâj unë?
Ti je infermier.	Ç'punë bân ti?
Ai âsht nxânës.	Ç'punë bân ai?
Na jemi ushtarë.	Ç'punë bâjmë na?
Ju jeni nënoficera.	Ç'punë bâni ju?
Ata janë oficera.	Ç'punë bâjnë ata?

Thuej Z. Saliut me ardhë këtu.
Z. Sali, eja(ni) këtu!
Thomu atyne me ardhë këtu.
Zotní, ejani këtu!
Thoni atij me shkue atje.
Zotní ...., shkoni atje!
Thoni Z. .... me lexue.
Z. .... lexoni!
Thoni Z. .... me shkrue.
Z. ...., shkrueni!

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Thoni Z. .... me punue mâ shpejt.
Z. ...., punoni mâ shpejt!

Thoni kujdestarit me këndue.
Z. ...., këndoni!
Thoni mësuesit me ju tregue nji përrallë.
Z. mësues, na tregoni nji përrallë!

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 49
PART V

PJESA E PESTË
USHTRIME PËRKËTHIMI

TRANSLATION EXERCISE

Shqipja dhe sorra

Nji herë nji shqipe (eagle) zûni nji zog dhe shkoi e rá në degë të nji peme për t'a hangër. Në të njâjtën degë po rrinte nji sorrë (crow).

"Sa mirë që e zûmë!" i tha sorra shqipes; "do të kënaqemi (to enjoy) me mish të freskët e të njomë."

"Jo" u-përgjegj shqipja, "këtu s'ka pjesë tjetër n'erí përveç atij që e zûni."

Sorra uli kryet e u-largue tue thânë me vete: "As tue u-lutë as tue kërkue nuk t'ep njerí gjâ, po nuk punove."

Dý macat e zemrueme

Nji macë e zezë, e trashë dhe e bukur, po ecte në majë të nji çatije (roof). Nga ana tjetër po vînte nji macë e kuqe, e fortë dhe e bukur si e para. Vendi i çatís ku po ecshin ishte shumë i ngushtë dhe çatija vetë shumë e pjerrët (inclined). Të dyja u-ndodhën përbáll njâna tjetrës.

"Me leje të kaloj" i tha e zeza së kuqes.

"Jo, nuk t'ap leje. Ti më lê të kaloj" i tha e kuqja.

Pa mendue aspak i këcyen në fyt njâna tjetrës,

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

por mjerisht të dyja ranë poshtë e mbaruen si âsht mâ keq.

Nji fjalë e vjetër thotë: "Zemrimi i tepruem (excessive) të verbon (blinds you)."

---

1. When you come to a certain point,there are two turns: the left leads to Durrës and the right to Shkodër.

2. He hurt his left hand more than the right one; of course, he is not able to work,but he doesn't care at all.

3. I invited them to stay for dinner,but they said that they wanted to go home; they were in a hurry.

4. The car broke down. A certain part in the motor, I don't recall the name of it, broke into two pieces.

5. I am very upset today. My uncle is in danger of dying. He has been ill for some time. I am sorry for my aunt,more than for anybody else.

6. Please go slowly. I cannot walk anymore, my feet hurt.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School

LESSON 49
PART VI
READING TEXT

PJESA E GJASHTË
COPË LEXIMI

Në nji gostí ay shqiptarë takohen. Njâni prej tyne ka lé në SHBA, por prindët e tij janë nga Devolli, kurse tjetri ka lé në Krujë. Zotní Rustemi ka nji gjelltore e ka edhe disa toka, të cilat u a ka dhânë dy bujqëve për t'i punue. Zotní Leka âsht arsimtár dhe ep mësime në gjuhën shqipe n'Institutin e Ministrís së Mbrojtjes për Gjuhë të Hueja. Ai i tregon Zotní Rustemit se Instituti gjindet në Presidio të Monterejt, Monterej, Kaliforní. Në këtë shkollë mësohen 26 gjuhë të hueja, ndër të cilat edhe shqipja. Ka gjuhë që mësohen në kurse gjashtë muejsh e nând' m'ejsh, kurse disa tjera mësohen në kurse nji vjeti e tetëmëdhetë muejsh. Pothuej të gjithë nxânsit janë ushtarakë e bâjnë pjesë n'Ushtrí, në Marinë, n'Aviacion dhe në Kambësorinë e Marinës. Ka edhe fare pak civila që janë nëpunës shteti ose nxânës t'Universitetit të Kalifornís. Nxânsit vîjnë në shkollë pesë ditë në javë e kanë gjashtë orë mësim në ditë: trí paradreke dhe trí mbasdreke. Zakonisht kanë 10 minuta pushim mbas çdo ore mësimi.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 49

QUESTIONS - PYETJE

1. Ku takohen dy shqiptarë?
2. Cili prej tyne ka lé në SHBA?
3. Prej nga janë prindët e tij?
4. Ku ka lé tjetri?
5. Kush ka nji gjelltore e disa toka?
6. Kujve u a ka dhânë tokat për t'i punue?
7. Kush âsht arsimtár?
8. Në ç'gjuhë ep mësime Zotní Leka?
9. Ç'punë bân Zotní Leka në I.M.M.Gj.H.?
10. Çfarë shkolle âsht Instituti?
11. Në cilin qytet gjindet kjo shkollë?
12. Sa gjuhë mësohen në këtë institut?
13. A âsht edhe shqipja nji ndër 26 gjuhët që mësohen në këtë shkollë?
14. Në çfarë kursesh mësohen gjuhët e ndryshme?
15. Çka janë pothuej të gjithë nxânsit e kësaj shkolle?
16. Ku bâjnë pjesë ata?
17. Çfarë nxânsish tjerë ka në këtë shkollë?
18. Sa ditë në javë vîjnë nxânsit në shkollë?
19. Sa orë mësim në ditë kanë nxânsit?
20. Sa orë mësim kanë ata paradreke e sa orë mbasdreke?
21. Sa minuta pushim kanë mbas çdo ore mësimi?

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School:

LESSON 49
PART VII
HOMEWORK

PJESA E SHTATË
DETYRË SHTËPIJE

A. Përkëtheni anglisht këto fjalí:

1. Gëzohem të ju njof.

2. Ai jeton në nji qytet të vogël në bregdetin prendimuer, në lindje të qytetit Okland.

3. S'kam fuqí t'eci mâ gjatë, prandej ju lutem vazhdoni pa mue.

4. Nuk e dij se kush âsht pronari i kësaj gjelltorje.

5. Nuk e pashë se ç'gradë kishte, por jam i sigurtë se ishte ushtarak.

B. Translate into Albanian;

6. Forgive me, I am wrong.

7. What's your name, please?

8. If they are born in the same country and speak the same language, they are called "fellow countrymen."

9. The Ministry (Department) of Defense and the Ministry of Interior are the most important departments in Albania.

10. He has been an educator all his life.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 49
PART VIII
VOCABULARY

PJESA E TETË
FJALORI

arsimtár, -i arsimtarë, -t	(m.)	educator (teacher or professor)
i, e, t'armatosun t'armatosuna	(adj. m. & f.)	armed
aviacion, -i	(m.)	aviation, air force
bashkatdhetár, -i bashkatdhetarë, -t	(m.)	fellow countryman
bregdét, -i bregdete, -t	(m.)	seashore
me drejtue (unë drejtoj)	(v.)	to lead, direct, show the way, run (a business); straighten
fuqí, -ja fuqí, -t	(f)	power, strength, force
me u-gëzue (unë gëzohem)	(v.)	to be glad, to be happy
gostí, -ja gostí, -t	(f.)	banquet, feast, formal dinner
gjelltore, gjelltorja gjelltore, -t	(f.)	a small restaurant, coffee shop
lindje, -a lindje, -t	(f.)	birth; east
marinë, -a	(f.)	navy
mbrojtje, -a	(f.)	defense
ministër, ministri ministra, -t	(m.)	secretary of a government dept., minister (not a religious term)
ministrí, -ja ministrí, -t	(f.)	ministry: a government dept. presided over by a minister; also, the bldg. in which its business is transacted

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Ministrija e Mbrojtjes		Department of Defense
me u-njoftë (unë njifem)	(v.)	to be known, recognized
me u-njoftë me ... (unë njifem me ...)	(v.)	to be acquainted with
i, të përbâmë e, të përbâme	(adj. m. & f.)	formed, made up, composed
i, e, të përbashkët të përbashkëta	(adj. m. & f.)	common, mutual
prendimuer, prendimore prendimorë	(adj. m. & f.)	western
pronâr, -i pronarë, -t	(m.)	owner, proprietor
student, -i studenta, -t	(m.)	student
ushtarak, -u ushtarakë, -t	(m.)	a military man

NOTES:

më falni!	Excuse me! Forgive me! I am sorry!
me leje?	May I? Excuse me! Allow me!
si e keni emnin?	What's your name?
sa mirë!	How nice!

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 50
PART I

PJESA E PARË
USHTRIME GRAMATIKORE PARAPRAKE-GRAMMAR PERCEPTION DRILL

1.
a. A âsht motra e Z. Jakovës mësuese?
Po, motra e Z. Jakovës âsht mësuese.
A âsht e motra mësuese në Durrës?
Po, e motra âsht mësuese në Durrës.
Kush âsht mësuese në Durrës?
E motra (e Zotní Jakovës) âsht mësuese në Durrës.
E motra e kujt âsht mësuese në Durrës?
E motra e Zotní Jakovës âsht mësuese në Durrës.
Çka âsht e motra (e Zotní Jakovës)?
E motra (e Zotní Jakovës) âsht mësuese në Durrës.
Ku âsht mësuese e motra (e Zotní Jakovës)?
E motra (e Zotní Jakovës) âsht mësuese në Durrës.
Në cilin qytet âsht mësuese e motra?
E motra âsht mësuese në Durrës.

A janë këto plaçkat e së motrës?
Po, këto janë plaçkat e së motrës.
Plaçkat e kujt janë këto?
Këto janë plaçkat e së motrës.
Cilat janë plaçkat e së motrës?
Këto janë plaçkat e së motrës.

A i tha Zotní Jakova së motrës me shkue në qytet?
Po, Zotní Jakova i tha së motrës me shkue në qytet.
Kujt i tha Zotní Jakova me shkue në qytet?
Zotní Jakova i tha së motrës me shkue në qytet.
Kush i tha së motrës me shkue në qytet.
Zotní Jakova i tha së motrës me shkue në qytet.
Çka i tha Zotní Jakova së motrës?
Zotní Jakova i tha së motrës me shkue në qytet.
Çka bâni Zotní Jakova?
Zotní Jakova i tha së motrës me shkue në qytet.

A foli të premten Zotní Jakova në telefon me të motrën?
Po, Zotní Jakova të premten foli në telefon me të motrën.
Me kë foli në telefon Zotní Jakova të premten?
Zotní Jakova foli të premten në telefon me të motrën.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Kush foli në telefon të premten me të motrën?
Zotní Jakova foli të premten në telefon me të motrën.
Çka bâni Zotní Jakova të premten?
Zotní Jakova foli të premten në telefon me të motrën.
Kur foli në telefon Zotní Jakova me të motrën?
Zotní Jakova foli të premten në telefon me të motrën.

A mori mbrâmë Zotní Jakova nji letër prej së motrës?
Po, Zotní Jakova mori mbrâmë nji letër prej së motrës.
Prej kujt mori letër mbrâmë Zotní Jakova?
Zotní Jakova mori mbrâmë nji letër prej së motrës.
Kush mori mbrâmë nji letër prej së motrës?
Zotní Jakova mori mbrâmë nji letër prej së motrës.
Çka mori mbrâmë Zotní Jakova prej së motrës?
Zotní Jakova mori mbrâmë nji letër prej së motrës.
Kur mori Zotní Jakova nji letër prej së motrës?
Zotní Jakova mori mbrâmë nji letër prej së motrës.
Sa letra mori mbrâmë Zotní Jakova prej së motrës?
Zotní Jakova mori mbrâmë nji letër prej së motrës.

b. A ka grueja e Gjergjit nji kapelë të ré?
Po, grueja e Gjergjit ka nji kapelë të ré.
A ka e shoqja (e Gjergjit) nji kapelë të ré?
Po, e shoqja (e Gjergjit) ka nji kapelë të ré.
Kush ka nji kapelë të ré?
E shoqja (e Gjergjit) ka nji kapelë të ré.
Çka ka e shoqja (e Gjergjit)?
E shoqja (e Gjergjit) ka nji kapelë të ré.
E shoqja e kujt ka nji kapelë të ré?
E shoqja e Gjergjit ka nji kapelë të ré.
Sa kapela të reja ka e shoqja (e Gjergjit)?
E shoqja (e Gjergjit) ka nji kapelë të ré.

A janë këto këpucë të së shoqes?
Po, këto këpucë janë të së shoqes.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Të kujt janë këto këpucë?
Këto këpucë janë të së shoqes.
Cilat këpucë janë të së shoqes?
Këto këpucë janë të së shoqes.

A i bleu Gjergji së shoqes nji sahat dore?
Po, Gjergji i bleu së shoqes nji sahat dore.
Kujt i bleu Gjergji nji sahat dore?
Gjergji i bleu së shoqes nji sahat dore.
Kush i bleu së shoqes nji sahat dore?
Gjergji i bleu së shoqes nji sahat dore.
Çka i bleu Gjergji së shoqes?
Gjergji i bleu së shoqes nji sahat dore.
Çfarë sahati i bleu Gjergji së shoqes?
Gjergji i bleu së shoqes nji sahat dore.

A u-takue Gjergji me të shoqen përpara zyrës?
Po, Gjergji u-takue me të shoqen përpara zyrës.
Me kë u-takue Gjergji përpara zyrës?
Gjergji u-takue me të shoqen përpara zyrës.
Ku u-takue Gjergji me të shoqen?
Gjergji u-takue me të shoqen përpara zyrës.
Kush u-takue me të shoqen përpara zyrës?
Gjergji u-takue me të shoqen përpara zyrës.
Çka bâni Gjergji?
Gjergji u-takue me të shoqen përpara zyrës.

A mori Gjergji prej së shoqes nji peshqesh për Krishtlindje?
Po, Gjergji mori prej së shoqes nji peshqesh për Krishtlindje.
Prej kujt mori Gjergji nji peshqesh për Krishtlindje?
Gjergji mori prej së shoqes nji peshqesh për Krishtlindje.
Kur mori Gjergji nji peshqesh prej së shoqes?
Gjergji mori prej së shoqes nji peshqesh për Krishtlindje.
Kush mori prej së shoqes nji peshqesh për Krishtlindje?
Gjergji mori prej së shoqes nji peshqesh për Krishtlindje.
Çka mori Gjergji prej së shoqes për Krishtlindje?
Gjergji mori prej së shoqes nji peshqesh për Krishtlindje.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

Sa peshqe-he mori Gjergji prej së shoqes për Krishtlindje?
Gjergji mori prej së shoqes nji peshqesh për Krishtlindje.

2.
a. A jeni tue folë shqip tash?
Po, tash jam tue folë shqip.
Çka po bâni tash?
Tash po flas shqip.

A jeni tue shkrue detyrën e shtëpís?
Po, jam tue shkrue detyrën e shtëpís.
Çka po bâni?
Po shkruej detyrën e shtëpís.
Kush po shkruen detyrën e shtëpís?
Unë po shkruej detyrën e shtëpís.
Cilën detyrë po shkrueni?
Po shkruej detyrën e shtëpís.

A jeni tue këndue nji libër historije?
Po, jam tue këndue nji libër historije.
Çka po këndoni?
Po këndoj nji libër historije.
Kush po këndon nji libër historije?
Unë po këndoj nji libër historije.
Çfarë libri po këndoni?
Po këndoj nji libër historije.

A jeni tue mendue ku me shkue nesër?
Po, jam tue mendue ku me shkue nesër.
Çka po mendoni?
Po mendoj ku me shkue nesër.
Çka po bâni?
Po mendoj ku me shkue nesër.
Kush po mendon ku me shkue nesër?
Unë po mendoj ku me shkue nesër.

b. A ishe tue fjetë mbrâmë n'orën 10?
Po, mbrâmë n'orën 10 ishem tue fjetë.
Çka po bâjshe mbrâmë n'orën 10?
Mbrâmë n'orën 10 po flêjshem.
Kush po flênte mbrâmë n'orën 10?
Unë po flêjshem mbrâmë n'orën 10.
Kur po flêjshe?
Po flêjshem mbrâmë n'orën 10.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

A ishte tue hangër Agimi kur shkova në mensë?
Po, Agimi ishte tue hangër kur ti shkove në mensë.
Çka po bânte Agimi kur unë shkova në mensë?
Agimi po hante kur ti shkove në mensë.
Kush po hante kur unë shkova në mensë?
Agimi po hante kur ti shkove në mensë.
Kur po hante Agimi?
Agimi po hante kur ti shkove në mensë.

3.
a. A do të shkoni nesër me gruen në Durrës?
Po, nesër do të shkoj me gruen në Durrës.
Kush po shkon nesër me gruen në Durrës?
Unë po shkoj nesër me gruen në Durrës.
Me kë po shkoni nesër në Durrës?
Nesër po shkoj në Durrës me gruen.
Çka po bâni nesër?
Nesër po shkoj me gruen në Durrës.
Kur po shkoni me gruen në Durrës?
Nesër po shkoj me gruen në Durrës.
Ku po shkoni me gruen nesër?
Nesër po shkoj me gruen në Durrës.

A do të vîjsh të marten me më pá?
Po, të marten do të vîj me të pá.
Kur po vjen me më pá?
Të marten po vîj me të pá.
Kush po vjen të marten me më pá?
Unë po vîj të marten me të pá.
Çka po vjen me bâ të marten?
Të marten po vîj me të pá.
Ç'ditë po vjen me më pá?
Të marten po vîj me të pá.

A do të rrijsh në shtëpí gjithë ditën të dielen?
Po, të dielen do të rrij në shtëpí gjithë ditën.
Kush po rrin në shtëpí të dielen gjithë ditën?
Unë po rrij në shtëpí të dielen gjithë ditën.
Çka po bân të dielen?
Të dielen po rrij në shtëpí gjithë ditën.
Kur po rrin në shtëpí gjithë ditën?
Të dielen po rrij në shtëpí gjithë ditën.
Ku po rrin të dielen gjithë ditën?
Të dielen po rrij në shtëpí gjithë ditën.

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

b. Unë do të blejshem nji kostum të rí po të kishem të holla.

Çka do të blejshe ti po të kishe të holla?
Unë do të blejshem nji kostum të rí po të kishem të holla.
Çka do të blente ai po të kishte të holla?
Ai do të blente nji kostum të rí po të kishte të holla.
Çka do të blejshim na po të kishim të holla?
Na do të blejshim nga nji kostum të rí po të kishim të holla.
Çka do të blejshi ju po të kishi të holla?
Unë do të blejshem nji kostum të rí po të kishem të holla.
Çka do të blejshin ata po të kishin të holla?
Ata do të blejshin nga nji kostum të rí.
Kush do të blente nji kostum të ri po të kishte të holla?
(Bâne këtë pyetje derisa t'ushtrohen në të gjitha vetjet.)

c. Unë do t'a lexojshem këtë libër po t'a kuptojshem.

Cilin libër do të lexojshe ti po t'a kuptojshe?
Unë do t'a lexojshem këtë libër po t'a kuptojshem.
Cilin libër do të lexonte ai po t'a kuptonte?
Ai do t'a lexonte këtë libër po t'a kuptonte.
Cilin libër do të lexojshim na po t'a kuptojshim?
Na do t'a lexojshim këtë libër po t'a kuptojshim.
Cilin libër do të lexojshem unë po t'a kuptojshem?
Ju do t'a lexojshin këtë libër po t'a kuptojshi.
Cilin libër do të lexojshin ata po t'a kuptojshin?
Ata do t'a lexojshin këtë libër po t'a kuptojshin.

Kush do t'a lexonte këtë libër po t'a kuptonte?
(Bâne këtë pyetje derisa t'ushtrohen në të gjitha vetjet.)

More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

d. Unë thash se do të shkojshem dje me autobus.

Kur do të shkojshe ti me autobus?
Unë do të shkojshem dje me autobus.
Kur do të shkonte ai me autobus?
Ai do të shkonte dje me autobus.
Kur do të shkojshim na me autobus?
Na do të shkojshim dje me autobus.
Kur do të shkojshem unë me autobus?
Ju do të shkojshi dje me autobus.
Kur do të shkojshin ata me autobus?
Ata do të shkojshin dje me autobus.

Kush do të shkonte dje me autobus?
(Bâne këtë pyetje derisa t'ushtrohen në të gjitha vetjet.)



More DLI courses on LiveLingua - Online Language School.

LESSON 50
PART II
DIALOGUE

PJESA E DYTË
DIALOGU

Muhabet kafesh

1. Enver! Ku je bre djalë se s'të kam pá ka ditë? Ulu se po të qeras nji gotë. Ç'do?
2. Të falem nderit. Do të dojshem nji birrë se kam et. Si shkon, Qazim?

3. Kamerier! Dý gota birrë! Mirë, mirë, po ti si shkon?
4. Mjaft mirë. A të duket se bân të ngrofët sot?

5. Hiqe pallton! A e njef at njerí që âsht n'at tavolinë atje?
6. E njof. Të shoqen e kam kushrînë. Pse pyet?

7. E takoj çdo mëngjes kur shkoj në punë. Ku punon?
8. Asht llogaritár në fabrikën e çveshjes s'orizit.

9. Sa e ka rrogën?
10. Aq sa marrin të gjithë nëpunësit: nja 450 lekë në muej.

11. Sa vetë ka në familje?
12. Ka t'âmën, të shoqen dhe të bijat; gjithësejt janë 5 vetë.

13. Si i del hesapi me mbajtë nji familje kaq të madhe?
14. E ndihmojnë të mbesat që ka n'Amerikë.

15. Sa i çojnë në muej?
16. Për nder nuk e dij. Ku e ke hallin ti që bân gjithë këto pyetje?

17. Kot pyes; thash se mos bân dallavere me llogarít e fabrikës.
18. Mos e thuej atë; âsht burrë i ndershëm e punëtuer.

19. Qe se na erdhën birrat. Gëzuar!
